



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

Podujevë, 13 maj 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiut të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 13 maj 2011 (e premte) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Adriatik“ në Orllan të Podujevës.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Projekti i GIZ-it për rini,
- Përgatitjet për provim shtetëror të maturës për klasat V dhe IX,
- Shqyrtimi i Udhëzimeve Administrative ,
- Plani për implementimin e formulës së financimit në nivel shkolle,

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Arsimit nga Komunitatet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë, z. Azem Guri.

PËRMBLEDHJA

z. Azem Guri, Kryesues i Kolegjiut- në hapjen e takimit falënderoj të pranishmit për kohën dhe gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje në këto takime. Një falënderim të posaçëm ishte edhe për mysafirët nga GIZ-i rreth diskutimit të projektit për rini. Kryesuesi tregoi për bashkëpunimin e mirë që ka pasur me z. Grzybek dhe shprehu kënaqësinë në vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Kryesuesi pastaj pa humbur kohë kaloi në pikën e parë të rendit të ditës ku i dha fjalën z. Grzybek në prezantimin e projektit.

➤ **Projekti i GIZ-it për rini**

z. Günter Grzybek, GIZ – sqaroi qëllimin e projektit i cili fokusohet në promovimin e pjesëmarrjes së rinisë në komuna dhe fuqizimin e rolit të tyre në shoqëri. Si një ilustrim z. Grybek përmendi fushëveprimin në disa komuna si Deçan, Gjakovë, Podujevë, Prizren, Junik, në themelin e qendrave rinore. Ai po ashtu shfaqti interesin që këtë projekt ta zbatojnë edhe komunitet tjera që të ketë një shtrirje sa më të gjerë në tërë Kosovën. Qëllimi kryesor është të ndihmojë në themelimin e strukturave komunale për rini, në ofrimin e trajnimeve e këshillave për rininë në komuna. Gjithashtu së bashku me MASHT-in po punojmë rreth përpilimit të Udhëzimeve Administrative që do të rregullojnë politikat rinore. Në kuadër të këtij angazhimi në bashkëpunim me komunitet kemi themeluar 29 zyra të Këshillit të Veprimit Lokal Rinor (KVRL), ku sigurojmë fonde për këto zyra në pajisje, shpenzime të takimeve, materiale shpenzuese etj. Roli kryesor i KVRL-ve do të jetë:

- fuqizimi i strukturave komunale për rini dhe
- zhvillimi i planeve të veprimit për rini.

Kjo është edhe arsyeja e pjesëmarrjes së AKK-së në kursimin e kohës, stafit dhe mjeteve financiare. Në përmes AKK-së do të ofrojmë ndihmën dhe mbështetjen në financimin e komisionit për rininë në kuadër të Kolegjiut të arsimit, ku do të diskutohen çështjet kryesore në interes të rinisë.

Kryesuesi – ceki se duhet të ketë një adresë për diskutimet rreth çështjeve të rinisë, andaj do të ishte mirë të krijojmë një komision për çështjet e rinisë ku do të përbëhej prej 5 anëtarëve nga drejtorët për kulturë, rini dhe sport nëpër komuna.

znj. Besa Hoxha Beqiri, Drejtoreshë e DKA-së, Rahovec – kërkoj të dijë se cila do të ishte ndihma për qendrat rinore të cilat janë themeluar deri më tash.

z. Grzybek – sqaroj se është në kontakt dhe bashkëpunim me këto zyra, në anën tjetër KVRL-të do të jenë pjesë kryesore për këto grupe rinore. Ato edhe do të mbështeten financiarisht si pjesë e përgjithshme e veprimit të KVRL-ve.

z. Remzi Salihu, Drejtor i DKA-së, Prishtinë – komentoj se Banka Botërore ka pasur qëllimin e themelimit të këshillave rinor, andaj si do procedojnë këto marrëdhënie të dy palëve rreth angazhimit të këtyre këshillave. A do të ketë përplasje për qëllimet e njëjta?

z. Grzybek – argumentoj se GIZ është në bashkëpunim me BB dhe kanë shkëmbim të informatave në mes tyre duke sqaruar se BB është e interesuar në punësimin e të rinjve, dhe se nuk do të ketë asnjë problem në këtë çështje. Deri më tash kemi identifikuar edhe 7 komuna ku nuk ka asnjë strukturë komunale për të rinjtë apo qendër ku do të diskutoheshin çështjet rinore, dhe me këtë rast ju premtoj strukturimin qendrave rinore në Shtërpce dhe Graçanicë gjatë muajve të ardhshëm.

Fatime Pllana, përgjegjëse në DKA, Obiliq- propozoj të merret iniciativa nga Kolegjiumi që të rekomandoj ndarjen në dy drejtori komunale atë të arsimit dhe kulturë, rini dhe sport në ato komuna ku nuk është bërë një gjë e tillë që të ketë një formë unike në tërë Kosovën.

Kryesuesi – pa humbur kohë rekomandoj që të dilet me një vendim nga Kolegjiumi për ndarjen e këtyre drejtorive në ato komuna ku nuk ka ndodhur një gjë e tillë, si dhe formimin e komisionit prej 5 anëtarëve, përfaqësues të drejtorive komunale për kulturë, rini dhe sport.

Pas një diskutimi të shkurtë u vendos që anëtarë të Komisionit për rini jenë këta persona:

Nexhmi Balaj - Podujevë

Anton Shala - Gjakovë

Vlora Dumoshi - Prishtinë

Almir Saiti - Prizren

Nazmi Iballi - Shtime

➤ **Përgatitjet për provim shtetëror të maturës për klasat V dhe IX**

Kryesuesi – uroj mirëseardhje mysafirëve nga MASHT-i, z. Alush Istogu - Sekretar Permanent si dhe z. Mustafë Kadriu - Udhëheqës i Njesisë për Standarde dhe Vlerësime.

z. Alush Istogu, Sekretar Permanent në MASHT - mbështeti idenë se ekziston një qëllim i përbashkët i punës në ngritjen e cilësisë në arsim. Lidhur me provimin e maturës duhet të kemi një bashkëpunim më të fortë në mes DKA-ve dhe Ministrisë, sepse sipas disa analizave në kuadër të monitorimit nga MASHT-i ende nuk kemi arritur një nivel të duhur. Po ashtu duhet të kemi disa vlerësime të punës në mes të AKK-së dhe MASHT-it rreth bashkëpunimit sa më të mirë të palëve .

Kryesuesi – do të ishte në interesin tonë të nxjerrim disa përfundime sa i përket provimit të maturës.

z. Mustafë Kadriu, Udhëheqës i Njësisë për Standarde dhe Vlerësime në MASHT- dha disa shpjegime lidhur me testin e maturës. Ai shpjegoi në pika konkrete për ecurinë e provimit të maturës, çështjen e administrimit, testit të maturës dhe përgatitjet e komunave rreth gjetjes së hapësirave të përshtatshme për mbajtjen e këtij provimi. Më tutje ai tregoi se testi do të jetë i njëjti si në vitet e kaluara me disa ndryshime të vogla, dhe po ashtu do të bëhen disa hulumtime për gjeneratat të cilat kanë kryer testin. Një çështje më rëndësi është administrimi sa më i suksesshëm i procesit në një bashkëpunim të ngushtë mes DKA-ve dhe MASHT-it. Testi do të jetë i standardizuar (nga PIZA - institut në vlerësime dhe standarde). Qëllimi i provimit të maturës është pranimi në universitet andaj edhe do të ketë pjesëmarrje të përfaqësuesve të universitetit në punën e administrimit të provimit të maturës. Komunat duhet të përgatiten për mbarëvajtjen e këtij procesi, gjetjen e hapësirave të nevojshme për mbajtjen e provimit të maturës që të kemi një plan konkret në fushën e organizimit. Testi në gjuhën shqipe është i gatshëm, ndërsa po përgatitet edhe në gjuhët tjera. Është llogaritur se për të dhënë përgjigjen në një pyetje, maturantëve do t'i nevojitet një minutë, ndërsa pagesa e testit do të jetë në vlerën prej 5 eurove plus 1 euro për shërbimet bankare.

z. Istogu – kërkoj një punë më të madhe të DKA-ve me drejtorët e shkollave, sepse në shkolla nuk mësohen lëndët mësimore nga arsimtarët sikurse janë të parashikuara në planet mësimore. Për këtë gjë kemi edhe vërejtje të mëdha nga inspektorët në teren.

Silvana Haxhikadrija, Drejtoreshë e DKA-së, Gjakovë - lidhur me këtë çështje duhet të parashtroj disa propozime për Këshillin Shtetëror të Maturës në menaxhimin e procesit të provimit të maturës, si vijon:

- Matura shtetërore të mos mbahet në restorante
- Menaxhimi të bëhet nga mësimdhënësit komunal
- Administrimi të jetë nga DKA-të

z. Qerim Selimi, Drejtor i DKA-së, Vushtrri - deri më tash përgatitjet e komunës kanë qenë maksimale, mirëpo duhet të përmend një çështje – ato komuna të cilat kanë zbatuar në mënyrë të rreptë disiplinën në menaxhimin e testit kanë pasur rezultat të dobët, ndërsa ato komuna që kanë pasur menaxhim të dobët dhe lëshime të mëdha kanë arritur sukses më të madh në testin e maturës. Andaj edhe duhet të ketë një vlerësim të drejtë në drejtimin e procesit nga komunat.

z. Istogu – sugjeroj se duhet të ketë një organizim sa më të mirë të procesit si në nivelin komunal ashtu dhe atij qendror, të ketë një planifikim rreth hapësirave të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit duke marrë parasysh se disa komuna kanë probleme me inventarin e tyre. Komunat do të jenë vetë

përgjegjëse për pagesën e hapësirave publike të cilat angazhon për provim të maturës. Rreth debatit se pse nxënësit detyrohen të paguajnë taksë për testin e maturës, z. Istogu sqaroi se kjo është vendosur Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që nxënësit të jenë më serioz dhe më përgjegjshëm për provimin e maturës.

➤ **Shqyrtimi i Udhëzimeve Administrative**

Kryesuesi – një çështje më rëndësi është ajo e punësimit të mësimitdhënësve deri në fundin e vitit shkollor, sepse kemi sugjerime të ndryshojë ky Urdhëresa Administrativ (UA) nga MASHT-i.

z. Istogu – ta keni të qartë se mësimitdhënësit nuk janë në kategorinë e shërbyesve civil por janë staf profesional, dhe është çështje e vetë DKA-ve nëse do të japë pëlqimin për vazhdimin e punës dhe pagesës së tyre.

Kryesuesi – të gjitha DKA-të do të duhej të respektonin UA-të edhe rreth çështjeve tjera, sikurse janë piknikët, shëtitjet, ekskursionet, etj.

z. Istogu – kërkesa për respektim të UA-ve nuk është rekomandim por obligim për të gjitha DKA-të, të cilat duhet sqaruar të gjitha palëve për t'u bërë të ditur (edhe drejtorëve të shkollave edhe nxënësve) pasojat e mundshme nga mosrespektimi i saj UA-ve gjatë organizimit të shëtitjeve të ndryshme.

z. Qerim Selimi, Drejtor i DKA-së, Vushtrri - duhet të ketë një rishikim të udhëzimeve administrative rreth emërimit të shkollave sepse vërehen disa mangësi në procedurat relevante.

z. Istogu – ta kemi të qartë se komuna do të kryejë të gjitha procedurat ndërsa është Ministria ajo që vendosë rreth emërimit.

z. Nazmi Krasniqi, Drejtor i DKA-së, Lipjan – kërkoj nga Sekretari i MASHT-it që të merren parasysh kërkesat e drejtorëve për plotësim-ndryshim të UA-ve në disa çështje, si zgjedhja e drejtorëve, mbishkrimi i shkollave (thjeshtësimi i tabelave), mungesa e mësimitdhënësve në mësim dhe kompensimi i personave zëvendësues, pagesa për orët e kujdestarisë, kalimi i obligueshëm i nxënësve prej klasës I deri tek V, vlerësimi i punës së mësimitdhënësve dhe lëndët fakultative, etj.

Kryesuesi – është mirë të diskutohen këto çështje në Kryesi dhe ta dalim me disa rekomandime

z. Istogu – po punojmë rreth unifikimit të mbishkrimeve në shkolla sipas një UA të ri, ndërsa sa i përket çështjes së kujdestarisë kjo kërkesë nuk është aprovuar nga ministri i financave për shkak të kostos së lartë.

➤ **Plani për implementimin e formulës së financimit në nivel shkolle**

Kryesuesi – sqaroi për takimin e drejtorëve në Mitrovicë dhe instruksionet dhe rekomandimet e dala në çështjen e financimit në komuna.

z. Istogu – përmendi se me formulën e re të financimit të shkollave do të jenë vetë drejtorët e shkollave ata të cilët do të kryejnë planifikimin buxhetor në konsultim së bashku me drejtoritë komunal të arsimit.

Duhet të ketë një racionalizim në shpërndarjen e nxënësve nëpër shkolla e mos të ketë koncentrim vetëm në një numër të caktuar shkollash, sepse kjo do të ketë pasoja në menaxhimin e buxheteve shkollore. Emërimi i drejtorëve do të rregullohet më ligjin e ri , tani problemi në praktikë mbetet tek 'emërimi politik' nga Kryetarët, por në të ardhmen mendohet që drejtorët të zgjedhën prej komisionit.

z. Jashar Lushtaku, Drejtor i DKA-së Skenderaj - në vazhdim përmendi disa probleme që duhet të jenë si pika të diskutimit në mes MASHT-it dhe DKA-ve, si çështja e inspektorëve si shkelës të ligjit, verifikimi i diplomave, problemi në emërimin e drejtorëve, licencimi i punëtorëve arsimor, etj.

Kryesuesi- sugjeroj se për shkak të temave të ndryshme me interes të përbashkët, të organizohen takimet të rregullta dhe të diskutohen këto çështje si pika të rendit të ditës.

Rekomandimet :

1. Formimi i komisionit për rini kulturë dhe sport në realizimin e projektit të përbashkët me GIZ-in
2. Provimi shtetëror i maturës të administrohet nga komunat në mënyrë më rigoroze
3. Procedurat e emërimit dhe mbishkrimeve në shkolla të specifikohen dhe të unifikohen në të gjithë Republikën e Kosovës
4. Të ndryshoj ligji për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave